



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë

Me datë: 22.11.2022

ENKELA KUCI

Tema: Vështirësitë socio-emocionale të nxënësve dhe ndërlidhja e tyre me motivimin për të nxënë

Komisioni:

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Beka, kryetare
Prof. Ass. Dr. Blerta P. Shehu, mentore
Prof. Ass. Dr. Albulena Metaj, anetare

ABSTRAKT

Zhvillimi socio-emocional i nxënësve është përcaktues shumë i rëndësishëm i zhvillimit të gjithëmbarshtëm të fëmijës dhe rezultateve të të nxënësve. Megjithatë, në kontekstin tonë, po i kushtohet rëndësi shumë e vogël, gjë që konsiderohet një mangësi duke pasur parasysh rolin që kjo fushë luan në përmirësimin e shëndetit mendor, mirëqenien e nxënësve dhe përmirësimin e rezultateve të të nxënësve (Polychroni F., Kotroni Ch., & Antoniou A., 2014). Studimi i kësaj teme është i rëndësishëm për arsye të analizimit më të thellë të kësaj situatë në vendin tonë, në shkollë, ku mund të ketë sfida dhe vështirësi në mësimnxënje dhe faktorë që mund të ndikojnë në zhvillimin, të nxënësve dhe sjelljen e nxënësve.

Ky studim ka për qëllim eksplorimin dhe evidentimin e formave më të shpeshta të vështirësive socio-emocionale në shkollë tek grupmoshat e klasave të 6-ta (11 vjeç), klasat e 7-ta (12 vjeç), klasat e 8-ta (13 vjeç) dhe grupmoshat e klasave të 9-ta (14 vjeç). Studimi tenton të eksplorojë faktorët që ndikojnë në formimin e këtyre vështirësive dhe të shqyrtojë ndërlidhjen që kanë ato me motivimin e nxënësve për të nxënë. Poashtu do të shqyrtohen edhe format e përkrahjes që ekzistojnë në shkollë për fëmijët me vështirësi socio-emocionale. Lidhur me qëllimin e këtij studimi janë parashtruar 5 pyetje hulumtuese të cilat shoqërohen me hipotezat e ngritura për secilën pyetje.

Ky hulumtim është një hulumtim sasior, ku të dhënat janë mbledhur përmes instrumentit – anketa dhe si instrument i saj, pyetësi anketues. Analizat që janë shtjelluar në këtë studim përfshijnë analizat statistikore deskriptive, analiza e korrelacionit dhe ajo e variancës. Procedurat për këtë hulumtim vijnë nga shqyrtimi i literaturës, hulumtim në institucione të vendit tonë, mbledhje e të dhënave, analizë e të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve. Pritshmëria e rezultateve lidhet me atë se faktorë të ndryshëm ndikojnë në vështirësitë socio-emocionale të nxënësve dhe këto vështirësi ndikojnë në të mësuarit e tyre.

Fjalët kyçe: *Arritje akademike, faktorë, metoda, vështirësitë socio-emocionale.*

ALBERTË GASHI

Tema: Nivelet dhe përputhshmëria e pyetjeve të testeve të matematikës me rezultatet e të nxënit bazuar në taksonominë e Bloom-it

Komisioni:

- 1. Prof. Dr. Naser Zabeli - kryetar**
- 2. Prof. Ass.Dr. Vjollca Ahmedi - anëtare**
- 3. Prof. Dr. Eda Vula- mentore**

ABSTRAKTI

Vlerësimi me test është një nga instrumentet më të vjetra që vazhdon të gjej përdorim në institucionet arsimore. Si një mjet i fuqishëm, shumë i njohur dhe i përdorur, posedon shumë hapa në hartimin e tij, ndër ta, cilësuar si një ndër hapat më të rëndësishëm është përmbajtja në rezultatet e të nxënit të lëndës përkatëse që përshkruajnë në kushte specifike dhe të matshme për atë që nxënësi do të dijë, ose do të jetë në gjendje ta bëjë pas një periudhe të caktuar kohore. Duke marrë parasysh që nxënësit kanë aftësi të ndryshme dhe mund të mësojnë në mënyra të ndryshme, rezultatet e të nxënit që mbështesin mësimdhënien duhet të shpërndahen në nivele të ndryshme të taksonomisë së rishikuar të Bloom-it. Pozicionimi i rezultateve të të nxënit të lëndës përkatëse në vetëm një nivel, apo në vetëm disa nivele të taksonomisë së rishikuar të Bloom-it, bën që praktikuesit e kurrikulës, mësimdhënësit, të ofrojnë edukim dhe vlerësim për kategoritë e atij apo atyre niveleve taksonomie. Andaj qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i niveleve të rezultateve të të nxënit të lëndës së matematikës të klasës së dytë dhe pyetjeve të testeve të përgatitura nga mësimdhënësit e klasave të dyta si dhe identifikimi i nivelit të përputhshmërisë mes tyre.

Qasja e hulumtimit është kualitative apo cilësore. Bazuar në qëllimin e hulumtimit është shfrytëzuar metoda e analizës së dokumenteve. Dokumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave janë: kurrikula lëndore për rezultatet e të nxënit të lëndës së matematikës së klasës së dytë dhe pyetjet e testeve të bëra nga mësimdhënësit e klasave të dyta. Analiza e dokumenteve është bërë duke iu referuar taksonomisë së rishikuar të Bloom-it dhe me ndihmën e programit Excel është bërë paraqitja e rezultateve në mënyrë grafike. Sipas rezultateve të analizës, u konstatua një pozicionim i lartë i rezultateve të të nxënit dhe pyetjeve të testeve në nivelin e aplikimit dhe një nivel i lartë i përputhshmërisë së pyetjeve të testeve me rezultatet e të nxënit të lëndës.

Fjalët kyçe: *rezultatet e të nxënit të lëndës, pyetjet e testeve, matematika, taksonomia e rishikuar e Bloom-it.*

AFERDITA SHALA

Tema: Qëndrimet e mësimeve të shkollës fillore rreth gjithëpërfshirjes së nxënësve me autizëm

Komisioni:

Prof. Dr. Naser Zabeli;

Prof. Ass. Ardita Devolli;

Prof. Ass. Ahurim Rasimi

Abstrakt

Autizmi është një çrregullim zhvillimor që shfaqet në tri vitet e para të jetës së një fëmije dhe ndikon ndaj zhvillimit normal të aftësive sociale dhe të komunikimit. Shfaqet e paraqitjes së autizmit nuk dihen saktësisht dhe ekzistojnë shumë teori rreth origjinës së tij.

Qëndrimet e mësimeve për integrimin dhe pritjet e tyre në lidhje me aftësitë shoqërore dhe akademike të nxënësve të tyre me autizëm ndryshuan mjaft. Ky ndryshim duket se lidhet jo vetëm me faktorë personal siç është aftësia e perceptuar për të përmbushur nevojat e nxënësve dhe shkalla e njohurive të specializuara, por edhe me faktorë të jashtëm siç janë shkalla e mbështetjes në klasë, informacioni apo burimet dhe udhëzimet profesionale që u dhanë në dispozicion gjatë trajnimeve.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte përcaktimi i qëndrimeve të mësimeve rreth pikëpamjeve të tyre rreth gjithëpërfshirjes së nxënësve me autizëm. Pra për afërsisht nëse ka diferenca sa i përket moshës, gjinisë, niveleve të arsimit, viteve të mësimit përvojës, lloji i qendrës dhe trajnimit i specializuar për autizëm, që lidhen me qëndrimet e mësuesve ndaj gjithëpërfshirjes së nxënësve në shkollat publike.

Në këtë hulumtim është përdorur pyetësori me 150 mësime të shkollave fillore. Ndërsa pjesë hulumtuese janë 35 nxënës me autizëm.

Qëndrimet e mësimeve rreth gjithëpërfshirjes janë pozitive në bazë të pyetjes të shtruar për mësuesit pjesëmarrës. Qëndrimet e mësimeve rreth specifikave të punës me nxënës me autizëm janë shprehur se përfshirja e fëmijëve me autizëm në mësime kërkon përkushtim të madh në punë.

Rol të rëndësishëm në qëndrimet pozitive të mësimeve rreth gjithëpërfshirjes së nxënësve me autizëm janë edhe trajnimet lidhur me nxënësit me NV dhe autizëm. Faktorët që ndikojnë në qëndrimet e mësuesve në klasat gjithëpërfshirëse janë: përvoja në mësime gjithëpërfshirëse; zhvillimi profesional i mësuesve; si dhe mbështetja administrative.

Fjalët kyçe: autizëm, mësime, qëndrim ndaj nxënësve autikë, sfida e mësimit.

FATIME HOXHA

Tema: Përfaqësimi i përmbajtjeve të edukimit gjithëpërfshirës në kurrikulën e arsimit Parauniversitar

**Komisioni: Prof. Dr. Naser Zabeli;
Prof. Ass. Ardita Devolli;
Prof. Asoc. Majlinda Gjelaç**

ABSTRAKTI

Qëllimi i arsimit është zhvillimi i potencialit të plotë, si ai intelektual, social dhe personal i të gjithë nxënësve duke u ofruar atyre një arsim të barabartë pavarësisht karakteristikave të tyre. Kurrikula është pa dyshim një fushë kryesore që mund të nxisë zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës, ose në rastin më të keq mund të jetë një pengesë për gjithëpërfshirjen. Studimi fokusohet në analizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, dokumenteve ligjore, e atyre pedagogjike mbi arsimin gjithëpërfshirës.

Studimi po ashtu bazohet në eksperiencën e nëntë mësimitdhënësve në shërbim, duke përshkruar qëndrimet, argumentet, sfidat, si dhe perspektivat gjatë zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës në praktikë, të dhëna këto të mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar.

Rezultatet janë analizuar dhe interpretuar përmes analizës tematike. Hulumtimi tregoi se mësimitdhënësit kanë një pasqyrë të qartë për legjislacionin dhe dokumentet pedagogjike, i konsiderojnë këto dokumente të hartuara mirë. Ndër të tjera mësimitdhënësit besojnë se nxënësit me nevoja të veçanta zhvillohen në aspektin social dhe emocional, kurse suksesi në arritjet akademike është më i ulët. Sidoqoftë mësimitdhënësit e shohin gjithë përfshirjen si një mundësi të shkëlqyer për të gjithë nxënësit. Ata rekomandojnë investime dhe bashkëpunim mes të gjithë partnerëve të përfshirë në procesin mësimor, për tejkalimin e pengesa që paraqiten gjatë rrugëtimit.

Fjalët kyçe: *arsimi gjithëpërfshirës, legjislacioni, kurrikula, dokumentet pedagogjike, sfidat e mësimitdhënësve.*

ARDIT JASHARI

Tema: Roli dhe ndikimi i prindërve në edukimin moral të fëmijëve në familje”

Komisioni:

Prof.Dr.Sc. Januz Dërvodeli – Mentor

Prof.Ass.Dr. Teuta Danuza – Kryetare e komisionit

Prof.Dr. Bahtije Gërbeshi – Anëtare e komisionit

Abstrakti

Në dekadat e fundit familja ka përjetuar ndryshimet më të mëdha dhe më të thella në të gjitha sferat e saj të funksionimit . Megjithatë , kuptimi i familjes nuk zvogëlohet , as roli i saj për fëmijët , që është në vendin më të lartë në shkallën e rëndësisë dhe prioritetit .

Familja e sotme është në një pozitë specifike të braktisjes së kufijve tradicionalë në të cilat ka qëndruar në mënyrë të sigurtë dhe të mbrojtur me autoritetin që kanë pasur prindërit dhe është përballur me sfidat e lëvizjeve demokratike që janë të pranishme në të gjitha fushat dhe në aspektin e jetës familjare . Në një vakum të tillë kur braktiset modelin tradicional të prindërisë dhe ende nuk ka udhëzime të qarta se si të bëhet një prind kompetent dhe përgjegjës në kushte të ndryshimeve shoqërore dhe tensioneve , prindërimi është bërë jashtëzakonisht i vështirë dhe konfuz . Andaj qëllimi i këtij hulumtimi është që ta kuptojmë rolin dhe ndikimin që kanë prindërit në edukimin moral tek fëmijët e tyre përkundër kalimit apo tranzicionit nga familjet më tradicionale në ato demokratike dhe moderne .

Tema ime do të përmbajë disa kapituj , duke filluar nga hyrja ku do të shtjellohet kryesisht ky fenomen që po e hulumtojmë e në këtë rast është pra ndikimi që kanë prindërit në edukimin moral të fëmijëve , qëllimi i këtij hulumtimi , pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit .

Nga kapitulli i dytë do të ketë shqyrtim literature të përditësuar duke shtjelluar e analizuar teori të ndryshme lidhur me hulumtimin . Sa i përket metodologjisë do përdori metodologjinë mikse duke kombinuar instrumentin e metodologjisë sasiore që është pyetësori por edhe nga metodologjia cilësore duke përdorur intervistat .

Pyetësorët do të zhvillohen me prindërit , duke bërë një kombinim të mjaftueshëm për ti analizuar dhe theksuar në veqanti ndikimin që kanë prindërit tek edukimi moral i nxënësve dhe do e shohim mënyrën e këtij ndikimi tek sjelljet e nxënësve në veprimtaritë e tyre edukativo-arsimore .

Fjalët kyçe: *Rol, ndikim, edukatë, moral, prindër, fëmijë, hulumtim.*

NAZIME HASANI

Tema: Vështrim / analizë e praktikave dhe politikave institucionale lidhur me regjistrimin e studentëve

Komisioni:

Prof. Asoc. Dr. Ethem Ceku- mentor

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Beka- kryetare

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Gjellaj

ABSTRAKTI

Arsimi i Lartë me shumë sakrificë i mbijetoi dhunës dhe terrorit serb ne vitet e 90-ta, mirëpo, pas luftës së fundit, po aq i rëndësishëm ishte edhe reformimi dhe modernizimi i tij sipas standardeve të përparuara evropiane me qëllim zhvillimin e një shoqërie të fortë e demokratike. Shteti është tërësi organizative shumë e përbërë që ushtron veprimtari të shumta. Veprimtari shumë e rëndësishme e tij është edhe arsimi. Shteti me mekanizmat e veta institucionale dhe legjislative, krijon politika arsimore që u përshtaten nevojave të shoqërive të dijes, krijon politika dhe praktika për të rritur cilësinë në arsim dhe për të përmbushur qëllimet e shumta të tij. Universiteti i Prishtinës sa ka qenë i rëndësishëm për popullsinë shumicë në Kosovë, po aq është konsideruar “ i rrezikshëm” për politikën ekspansioniste serbe, edhe pse veprimtarinë e vet e ka ushtruar me sukses, në dy gjuhë mësimore (shqip dhe deri në vitet e nëntëdhjeta edhe në gjuhën serbe). Politikat e regjistrimit të studentëve në arsimin e lart para luftës në Kosovë, të shumtën e rasteve i kanë përfillur rekomandimet e organeve vendimmarrëse në periudha të ndryshme, varësisht nga qëndrimet e organeve politike (LKJ). Ato ndryshonin vazhdimisht, nga liberalizimi i skajshëm, parimi i paritetit, e deri te “censurimi i skajshëm”, separatizmi – ndarja sipas gjuhëve mësimore, okupimi i tij dhe në fund “largimi me dhunë i mësimdhënësve dhe studentëve “jo serb” nga e drejta e arsimimit ne gjuhen e tyre amtare!

Pas lufte, politikat e regjistrimit të studentëve në arsimin e lartë, synonin të ishin më demokratike dhe më përgjithësuese. Megjithatë, ato ndryshuan vazhdimisht, varësisht nga rrymimet politike të një shoqërie të re, më me prosperitet dhe më demokratike. Me themelimin e institucioneve tjera publike e private të arsimit të lart, ato u bënë gjithnjë e më liberale, por edhe më të sofistikuara.

Fjalët kyçe: *Arsimi i Lartë, politikat institucionale, cilësia, strategjitë, regjistrimi i studentëve.*

BESA ZEQRIRI

Tema: Qëndrimet e nxënësve dhe të mësimitdhënësve të shkollës fillore për mësimin online në komunën e Ferizajt

Komisioni:

Prof. Januz Dervodeli, mentor

Prof. Hatixhe Ismaji, kryetare

Prof. Florent Bunjaku, anëtar

ABSTRAKTI

Ky punim diplome ka për qëllim që të analizojë qëndrimet e nxënësve dhe të mësimitdhënësve të shkollës fillore për mësimin online në komunën e Ferizajt. Qëllimi i hulumtimit është evidentimi i qëndrimeve të nxënësve dhe mësimitdhënësve të shkollës fillore për mësimin online. Të mësuarit online është revolucion i arsimit të një vendi. Të mësuarit online trajtohet si mësim në të ardhmen dhe mëton të jetë vazhdimësi e të mësuarit tradicional e nuk ka për synim përmbysjen e klasave fizike dhe praninë e mësuesit në klasë. Hipoteza e përgjithshme e këtij hulumtimi nga e cila edhe kemi filluar hulumtimin është se mësimi online është sfidues por me punë dhe përkushtim jep rezultatet që mësimitdhënësit presin me bashkëpunim në mes të dyja palëve nxënës-mësimitdhënës në shkollat fillore. Kësaj hipoteze i shtojmë edhe dy hipoteza të cilat do të na ndihmojnë të vërtetojmë hipotezën kryesore.

Metodologjia e hulumtimit është sasiore apo kuantitative për përpunimin e së cilës jemi mbështetur në të dhëna statistikore, ku përmes pyetësorëve krijohet një bazë e të dhënave dhe pastaj ato të dhëna përpunohen, analizohen dhe interpretohen. Andaj, përmes këtyre metodave kemi kompletuar dhe analizuar përfundimet e këtij problemi.

Si instrument vlerësimi i përdorur në këtë hulumtim është pyetësori i cili është implementuar fizikisht te mësimitdhënësit dhe nxënësit e shkollës fillore mbi mbajtjen e mësimit online në klasat IV-V të shkollave fillore në qytetin e Ferizajt.

Rezultatet e pritura pas analizimit të të dhënave dhe hipotezat e ngritura në këtë studim do të vërtetohen mbi procesin e të nxënësve ose edhe do të rrëzohen, me ç'rast mund të arrihet në rezultate të kundërta të hipotezave të vendosura gjatë këtij hulumtimi.

Për të bërë një hulumtim të tillë jemi fokusuar në disa shkolla fillore në komunën e Ferizajt, ku të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorëve janë analizuar dhe janë prezantuar rezultatet lidhur me qëndrimet e nxënësve dhe të mësimitdhënësve të shkollës fillore për mbajtjen e mësimit online në komunën e Ferizajt.

Fjalët kyçe: *Mësimitdhënës, nxënës, shkollë, qëndrimet, mësim, online.*

KOSOVARE REXHEPAJ

Tema: Aplikimi i teorisë konstruktiviste në mësimdhënie

Komisioni:

Mentor Prof. Dr. Januz Dervodeli

Anetar Prof. Dr. Hatixhe Ismajli

Anetar Prof. Dr Vjollca Ahmedi

ABSTRAKT

Për shumë vite qasjet tradicionale kanë qenë dominuese në praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat e Republikës së Kosovës. Këto qasje në parim e shihnin nxënësin si marrës apo pranues të dijes dhe se mësimdhënësi kishte kontroll të plotë mbi nxënësit dhe lëndën që e ligjëronte. Por reformat e nisura në arsim në vazhdimësi kanë venë në pah tendencën drejt qasjeve dhe modeleve bashkëkohore të cilat në qendër të procesit edukativo-arsimor e vendosin nxënësin. Ky studim ka analizuar qasjet dhe teoritë e mësimdhënies me theks të veçantë qasjen konstruktiviste të mësimdhënies. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 130 mësimdhënës nga komuna e Skenderajt. Përzgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë të rastësishme, 18 prej tyre kanë qenë meshkuj dhe 112 kanë qenë femra. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda e analizës teorike për paraqitjen e kuadrit teorik. Pastaj është aplikuar metoda përshkuese duke krijuar mundësi për interpretimin dhe përshkrimin verbal të rezultateve. Për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave është përdoruar një pyetësor që përpos disa pyetje demografike i ka përmbajtur 15 pyetje më alternativa kryesisht të ndryshme. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të elaburohet kuadri teorik dhe praktik i aplikimit dhe zbatimit të teorisë konstruktiviste në edukimin e nxënësve si dhe të përcaktohet niveli i ndikimit të teorisë konstruktiviste në mësimdhënie në kuadër të procesit të zbatimit të mësimdhënies.

Fjalët kyçe: *Teori, konstruktivizmi, mësimdhënia, arsimin fillor.*

QENDRESA REXHEPAJ

Tema: Ndikimi i metodave bashkëkohore në realizimin e suksesshëm të punës edukative – mësimore në shkollat fillore

Komisoni:

Mentor Prof. Dr. Januz Dervodeli

Anetar Prof. Dr. Hatixhe Ismajli

Anetar Prof. Dr Vjollca Ahmedi

ABSTRAKT

Për shumë vite qasjet tradicionale kanë qenë dominuese në praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat e Republikës së Kosovës. Këto qasje në parim e shihnin nxënësin si marrës apo pranues të dijes dhe se mësimdhënësi kishte kontroll të plotë mbi nxënësit dhe lëndën që e ligjëronte. Por reformat e nisura në arsim në vazhdimësi kanë venë në pah tendencën drejt qasjeve dhe modeleve bashkëkohore të cilat në qendër të procesit edukativo-arsimor e vendosin nxënësin. Ky studim ka analizuar qasjet dhe teoritë e mësimdhënies me theks të veçantë qasjen konstruktiviste të mësimdhënies. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 130 mësimdhënës nga komuna e Skenderajt. Përzgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë të rastësishme, 18 prej tyre kanë qenë meshkuj dhe 112 kanë qenë femra. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda e analizës teorike për paraqitjen e kuadrit teorik. Pastaj është aplikuar metoda përshkruese duke krijuar mundësi për interpretimin dhe përshkrimin verbal të rezultateve. Për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave është përdoruar një pyetësor që përpos disa pyetje demografike i ka përmbajtur 15 pyetje më alternativa kryesisht të ndryshme. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të elaburohet kuadri teorik dhe praktik i aplikimit dhe zbatimit të teorisë konstruktiviste në edukimin e nxënësve si dhe të përcaktohet niveli i ndikimit të teorisë konstruktiviste në mësimdhënie në kuadër të procesit të zbatimit të mësimdhënies.

Fjalët kyçe: *Teori, konstruktivizmi, mësimdhënia, arsimin fillor*

FLORENTINA JETULLAHU

Titulli: Qëndrimet e mësimeve për ndikimin e teksteve të leximit letrar në zhvillimin e të menduarit kritik

Komisioni:

- 1. Prof. Myrvete Dreshaj Baliu, mentore**
- 2. Prof. Hatixhe Ismajli, kryetare**
- 3. Atdhe Hykolli, anëtar**

Abstrakti

Tema e këtij hulumtimi ka të bëjë me zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve përmes teksteve shkollore të leximit letrar.

Zhvillimi i të menduarit kritik është një nga synimet kryesore që përpiqet të arrihet te nxënësit përgjatë procesit edukativo-arsimor. Një zhvillim të tillë së pari e përcakton Kurrikula e cila është organizuese e procesit mësimor, por të menduarit kritik arrihet edhe përmes teksteve shkollore.

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është: A ndikojnë mjaftueshëm tekstet e leximit letrar në zhvillimin e të menduarit kritik te nxënësit e shkollës së dytë?

Ndërsa hipoteza e këtij hulumtimi është: Tekstet letrare ndikojnë në mënyrë të kënaqshme për zhvillimin e të menduarit kritik te nxënësit.

Për arritjen e rezultateve sa më të sakta dhe të dobishme, në këtë hulumtim janë përdorur pyetësorët dhe intervistat që janë realizuar me mësimeve dhe nxënësit e shkollës së dytë të Kurrikulës. Pyetësorët janë realizuar përmes metodës sasiore dhe cilësore. Pyetësorët e realizuar për mësimeve janë gjysmë të strukturuar, pra janë përfshirë metoda sasiore dhe cilësore. Kurse, për pyetësorët me nxënës është përdorur vetëm metoda sasiore. Pjesëmarrës të këtij hulumtimi janë 15 mësimeve dhe 150 nxënës .

Të gjitha të dhënat sasiore të grumbulluara përmes pyetësorëve janë analizuar me anë të paketës statistikore për shkencat sociale SPSS, kurse të dhënat cilësore janë analizuar me analizë tematike.

Rezultatet e fituara nga ky hulumtim janë një reflektim i asaj se sa ndihmojnë tekstet letrare që të zhvillohet të menduarit kritik dhe gjithashtu do të jetë edhe një shërbyes për përmirësimin e teksteve letrare, në mënyrë që të përshtaten tekstet me rezultatet e të nxënësit dhe të ndikojnë më shumë në zhvillimin e të menduarit kritik.

Fjalët kyçe: mendim kritik, mësimeve, nxënës, tekste letrare, zhvillim.

MERITA SEJDIU

Tema: Praktikrat e edukatoreve në krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse në grupmohën e fëmijëve 0-6 vjeç

Komisioni:

- 1. Prof. Asoc. Vlora Syla**
- 2. Prof. Ass. Rozafa Ferizi- Shala**
- 3. Prof. Asoc. Majlinda Gjelij**

ABSTRAKTI

Vitet e fëmijërisë së hershme janë thelbësore për zhvillimin e fëmijës në tërësi, gjatë kësaj kohe gjithçka zhvillohet dhe merr formë për vitet e mëvonshme dhe edukatorët përbëjnë një rëndësi nga shtyllat kryesore në nxitjen e një zhvillimi të mirëfilltë dhe të shëndoshë, e cila ka dobitë e panumërta jo vetëm për vetë fëmijën por edhe për tërë shoqërinë. Edukatorët kanë rëndësi të padiskutueshme në krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse në dhomë të punës dhe më gjerë, duke ofruar mundësi të shumëllojshme për fëmijët, në mënyrë që të mbjellë tek ta dashurinë, kujdesin, barazinë dhe të gjitha vlerat tjera të mira tek ta. Prandaj ky hulumtim pikërisht ka vënë në fokus praktikrat e edukatoreve në krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse tek fëmijët, më specifikisht në grupmohën e fëmijëve 0-6 vjeç.

Hulumtimi ka pasur për qëllim identifikimin e praktikave të edukatoreve në krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse në grupmohën e fëmijëve 0-6 vjeç, si dhe të vlerësoj rolin edukatorit/ës në realizimin e gjithëpërfshirjes, poashtu ndër të tjerash janë diskutuar edhe sfidat që hasin edukatorët në këtë drejtim. Studimi është bërë në formë përshkruese, dhe u mbështet në metodën mikse dhe teknika e përdorur në këtë studim është intervista e gjysëm-strukturuar dhe pyetësori online ku janë përfshirë pyetje me alternativa.

Nga rezultatet dhe të dhënat ndër të tjerash janë nxjerrur informacione të mjaftueshme që pasqyrojnë situatën aktuale nëpër institucionet parashkollore, nga këto vlen të përmendet se edukatorët, në përgjithësi, i kushtojnë rëndësi gjithëpërfshirjes dhe se gjithëpërfshirja është obligim profesional dhe human gjithashtu të dhënat ngrisin lartë rolin e edukatorit/ës në krijimin e gjithëpërfshirjes gjithmonë në bashkëpunim edhe me akterë tjerë të edukimit poashtu njëra ndër sfidat që është përmendur më së shumti si vështirësi në arritjen e gjithëpërfshirjes në grupmohën e fëmijëve 0-6 vjeç është numri i madh i fëmijëve nëpër grupe edhe pse ky numër në të shumtën e rasteve është i rregulluar përmes udhëzuesëve administrativ. Më pas janë paraqitur konkluzione dhe rekomandime për hapa të mëtutjeshme të cilat do t'i kontribuojnë edhe më shumë edukatoreve dhe faktorëve tjerë të edukimit për praktikrat që dërgojnë në arritjen e gjithëpërfshirjes në punën e tyre, e sidomos tek fokusi i hulumtimit sa i përket moshës 0-6 vjeç.

Fjalët kyçe: *Edukatore, fëmija, grupmosha 0-6 vjeç, kultura gjithëpërfshirëse, praktikrat e edukatoreve.*